

Më shumë Qumësht me më shumë ujë



Ushqyerja e lopëve të qumështit

Rrjeti i furnizimit me ujë të lopëve të qumështit mund të jetë një faktor që përcakton sasinë e prodhuar të qumështit. Mungesa e sasisë të mjaftueshme të ujit të pijshëm tek lopët redukton në mënyrë direkte procesin e ripërtypjes dhe kështu kufizon marrjen e substancave të thata.

Qumështi përbëhet nga rreth 87% ujë. Prandaj, lopët e qumështit kanë një nevojë më të madhe për ujë se sa kafshët e tjera të fermave.

10 L për 30 sekonda

Në varësi të temperaturës së ambientit, lopët e qumështit gjatë laktacionit kanë nevojë për 4-5 herë më shumë ujë sesa sasia përfundimtare e prodhimit të qumështit. Në varësi të racionit të ujit, të temperaturës së ambientit dhe redimentit të qumështit, lopët me performancë të lartë mund të pijnë deri në 180 L ujë në ditë. Matjet kanë treguar që lopët mund të pijnë në burime të hapura deri në 25 L në minutë. Një pirje mesatare uji e një lope zgjat rreth 30 sekonda dhe gjatë kësaj kohe lopa pi përafërsisht 10 L ujë.

Shenjat treguese të mungesës të ujit tek lopët janë: ngrënia e pamjaftueshme e ushqimit të thatë, pamjaftueshmëri në sasinë e prodhuar, jashtëshitje e thatë, cikle pirjesh uji të çrregullta.

Më mirë hapur

Lopët pijnë ujë me kokën drejtuar përpara. Për këtë arsye ato preferojnë burime, ku ato mund të fusin kokën lehtësisht. Burimet e ujit të hapura i përshtaten kësaj nevojë më së miri. Depozitat e montuara në lartësinë 80 cm i përshtaten më së miri mënyrës natyrale të pirjes së ujit.

Depozitat e ujit duhet të pozicionohen strategjikisht, në mënyrë që gjatë marrjes së ujit kafshët të mos shqetësohen nga kafshët e tjerë të rangut më të lartë, apo edhe të mos pengohen për të pirë ujë.

Ne rastet kur hapësirat janë të ngushta ose të kufizuara ja vlen që 2 depozita të ndërtohen ngjitur me njëra-tjetrën.

Stallat padok e kanë të lehtë të kostantojnë që lopët pijnë rregullisht ujë gjatë ditës.

Vendi më i rëndësishëm i ujit gjendet pas vendit të mjeljes, sepse lopët marrin 1/3 e nevojës të tyre për ujë direkt pas mjeljes. Në qoftë se mundësitë e pirjes janë afër lugut të ushqimit, atëherë do të pihet më shpesh edhe më shumë ujë nga lopët.

Një rol shumë të rëndësishëm e luan edhe lloji i tokës në vendin e pirjes së ujit. Stallat profesionale të lopëve vendosin në ambjentet e ushqimit edhe të pirjes tapeta gome, në mënyrë që lopët të rrinë sa më gjatë edhe pa dhimbje në këto ambjente.

Jo shumë i ftohtë

Për një kohë të gjatë ka qenë mendimi, që ngrohja e ujit rrit prodhimin e qumështit tek lopët me performancë të lartë si dhe është në të mirë të shëndetit të tyre. Rreth kësaj çështjeje janë bërë studime të ndryshme. Rezultatet tregojnë që: lopët preferojnë më shumë ujin e vakët (16 °C) se sa ujin e ftohtë (4 °C), por sasia e konsumuar e ujit të vakët nuk është më e lartë në krahasim me konsumimin e ujit të ftohtë. Prodhimi dhe përmbajtja e qumështit janë më të larta kur lopët pijnë ujë të ftohtë.

Temperaturat e ulëta ndihmojnë bakteriet tretëse në rumen, gjë që sjell rritjen e acidit acetic në stomak.

Së fundmi, nuk ka ndonjë arsye që stallat ta ngrohin ujin artificialisht. Uji i çezmës me temperaturë normale ndërmjet 5 °C – 14 °C është mëse i mjaftueshëm.

Të pirit në vendin e mjeljes

Në Gjermani edhe në Hollandë kjo metodë po gjen gjithmonë e më shumë mbështetës. Shumë herë mjafton që në vendin e pirjes në pjesën e kokëve të kafshëve të sillet një tub PVC i përgjysmuar. Nëpërmjet kësaj mënyre të thjështë funizimi me ujë arrihet që lopët të pinë 10 L më shumë ujë në ditë. Nëpërmjet kësaj mënyre mund të arrihen edhe performanca të tjera të pasigurta.

Vecanërisht në stallat me sistem të lidhur rrjeti i furnizimit me ujë është i pamjaftueshëm. Depozitat e vjetra të pirjes së ujit me një rrjedhje 2-3 L ujë për minutë, çojnë në një kohë pirje më të gjate edhe kështu detyrimisht në pamjaftueshmëri uji për kafshën.

Depozitat e hapura në stallat padok mund ta përmisojnë ndjeshëm situatën. Depozitat e reja janë të konceptuara që të kenë një rrjedhje uji prej 18 L per minutë, në këtë mënyrë janë edhe më dashamirëse me kafshët. Depozitat e vjetra mund të përmisohen nëpërmjet shpimit të rrjedhjes së ujit.

Sidoqoftë, depozitat e hapura me sistem automatik pirjeje preferohen më shumë.

Nje rëndësi të vecantë ka edhe ujitja e fushës. Pavarësisht përmbajtjes të lartë të ujit në bar, në verë do të nevojitet më shumë ujë. Të pirit nga depozita i kombinuar me rezervuarët e hapur do të rriste sasinë e ujit të pirë nga lopët.

Përfundimi

Në shumë stalla ka mundësi rritjeje të rrjetit të furnizimit me ujë të kafshëve, në këtë menyrë rritet edhe performanca e lopëve në prodhimin e qumështit. Pajisjet e pirjeve që plotësojnë nevojat e kafshëve në mënyrë optimale, çojnë në rritje të konsumit të ushqimit nga kafsha si dhe në rritje të sasisë së qumështit. Përvec pastërtisë, është vendodhja dhe shpejtësia e rrjedhës së ujit me rëndësi shumë të vecantë. Burimet e ujit të hapura janë të preferuara. Temperatura e ujit luan një rol jo shumë të rëndësishëm.